

TITULLI II

Shënime dhe të dhëna për Listën e artikujve Transit/Siguri

Shkurtesa 'PVP' ('Proçesi i Vazhdimësisë së Punës') e përdorur në këtë kapitull u referohet situatave ku gjen zbatim procedura fall back e përcaktuar në VKM 447, miratuar në përputhje të Nenit 18(d) të Kodit dhe përcaktuar në aneksinAneksi 72-04 të së njëjtit vendim. Lisat e artikujve Transit/Siguri duhet të përmbajë të dhëna specifike për artikujt e mallrave në deklaratë.

Kutitë në listën e artikujve janë të zgjerueshëm vertikalisht. Përveç dispozitave në shënimet shpjeguese të AneksiAneksi B, të dhënat duhen printuar si më poshtë dhe, nëse mundet, të përdoren kodet:

1) Kutia MRN — siç përcaktohet në AneksinAneksi B-04.

MRN duhet printuar në faqen e parë dhe në të gjitha listat e artikujve përveç rastit kur këta formularë përdoren në kontekstin e BCP, raste ku MRN nuk ndahet sipas zërave.

(2) Të dhënat e kutive të ndryshme në nivelin e artikujve duhen printuar si më poshtë:

a) Kutia Artikull Nr (1/6) — numri serial i artikullit aktual;

b) Kutia TCMPC (4/2) — vendos kodin e pagesës për detyrimet mbi mënyrën e transportit;

c) UNDG (6/12) — Kodi i mallrave të rrezikshme sipas OKB-së;

ç) kutia e formularëve (1/4):

— Nënndarja e parë: numri serial i fletës së printuar aktuale

— Nënndarja e dytë: numri total i fletëve të printuara (Lista e artikujve Transit/Siguri)